



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 11, pika 11.3 e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, për ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe të nenit 32, pika 32.1 shkronja i e Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2008, nxjerr

V E N D I M

**MBI LIRIMIN NGA TARIFAT KOMUNALE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTACIONIT –
DHËNIEN E CERTIFIKATAVE NGA SHËRBIMI I OFIQARISE PËR FAMILJARËT E
DËSHMORËVE, INVALIDËT E LUFTËS, PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA,
PRINDËRIT DHE FËMIJËT E MITUR TË TË BURGOSURVE POLITIKË TË VDEKUR
DHE RASTET SOCIALE**

- I. Miratohet Vendimi për lirim nga tarifat komunale për lëshimin e dokumentacionit – dhënie e certifikatave nga Shërbimi i ofiqarisë për familjarët e dëshmorëve, invalidët e luftës, personat me aftësi të kufizuara, prindërit dhe fëmijët e mitur të të burgosurve politikë të vdekur dhe rastet sociale.
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit të Komunës së Prishtinës.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas certifikimit të tij nga Komisioni për certifikimin e rregulloreve për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.400-627,më 21.5.2008

KRYETAR I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa

